



STATUT

I SHOQERIS ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

“ Enso Holding” sh.p.k

KREU I

EMERTIMI- OBJEKTI-SELIA-KOHEZGJATJA

NENI 1

Sot, më datë 30.01/2021 në Tiranë, Shqipëri, nga personat e mëposhtëm:

Z. Avni Delvina, shtetas italian , lindur më 14.01.1958, banues në Cesena Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. AT3645834, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Z. Skender Delvina, shtetas italian , lindur më 24.08.1974, banues në Rimini Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. CA53069FC, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Znja. Reveka Delvina, shtetas italian , lindur më 25.10.1946, banues në Rimini Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. CA335456D, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Z. Ymer Delvina, shtetas shqiptar , lindur më 28.09.1979, banues në Rimini Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. H90928042U, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Z. Melios Delvina, shtetas shqiptar , lindur më 16.01.1987, banues në Rimini Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. I70116063D, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Znja. Nimet Delvina, shtetas shqiptar , lindur më 11.02.1924, banues në Verucchio Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. C45211010P, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Znja. Dajana Delvina, shtetas italian , lindur më 10.05.1984, banues në Santarcangelo Itali, mbajtës i letërnjoftimit nr. CA72607HM, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Z. Eros Delvina, shtetas italian , lindur më 01.06.1986, banues në Verucchio Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. AT3517605, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Znja. Mimoza Pilika, shtetas italian , lindur më 06.10.1950, banues në Verucchio Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. CA92631AR, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Handwritten signatures and stamps:

- Vertical signature on the left: *Delvina*
- Vertical signature on the right: *Delvina*
- Horizontal signatures at the bottom: *Delvina*, *Delvina*, *Delvina*, *Delvina*, *Delvina*, *Delvina*

eshte themeluar shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar " **Enso Holding** " sh.p.k.

Shoqeria " **Enso Holding** " sh.p.k. eshte person juridik i se drejtes shqiptare, e organizuar ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe si e tille do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar ne perputhje me dispozitat e Statutit te shoqerise -dhe ne perputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, date I 4.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne perputhje me ligjin nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi. Shoqeria do t'i nenshtrohet legjislacionit Shqiptar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit perkates ku do te kete seline dega e miratuar


NENI 2

Shoqeria Tregtare eshte vendase dhe quhet " **Enso Holding** " **Sh.p.k** ,emertim i cili dote jete i stampuar dhe ne vulen e saj.


NENI 3

Selia Qendrore e Shoqerise " **Enso Holding** " **Sh.p.k** ndodhet në adresën: Rruga Siri Kodra Pallati Pegaso Nr. 30 Apt 22 Tirane

NENI 4

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne te gjithë juridiksionin e territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit, 

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve mund te krijohen ose anulohen (ne rast se jane celur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperi edhe jashte shtetit.


N jesite e tjera strukturore te shoqerise, si Dege apo Perfaqesi jashte shtetit krijohen kur nje gje e tille lejohet nga legjislacioni i vendeve te huaja dhe normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme. 

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontribute ne para dhe eshte 10,000 (dhjete mije) Leke, i formuar dhe nenshkruar nga Ortaket Themelues :ne kete menyre :

Z. Avni Delvina, shtetas italian , lindur më 14.01.1958, banues në Cesena Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. AT3645834, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

51% te kuotave



Z. Skender Delvina, shtetas italian , lindur më 24.08.1974, banues në Rimini Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. CA58068FG, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

4% te kuotave

Znja. Reveka Delvina, shtetas italiane , lindur më 25.10.1946, banues në Rimini Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. CA335456D, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

4% te kuotave

Z. Ymer Delvina, shtetas shqiptar , lindur më 28.09.1979, banues në Rimini Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. H90928042U, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

4.5% te kuotave

Z. Melios Delvina, shtetas shqiptar , lindur më 16.01.1987, banues në Rimini Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. I70116063D, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

4.5% te kuotave

Znja. Nimet Delvina, shtetas shqiptar , lindur më 11.02.1924, banues në Verucchio Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. C45211010P, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

15.5% te kuotave

Znja. Dajana Delvina, shtetas italian , lindur më 10.05.1984, banues në Santarcangelo Itali, mbajtës i letërnjoftimit nr. CA72607HM, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

5.5% te kuotave


Z. Eros Delvina, shtetas italian , lindur më 01.06.1986, banues në Verucchio Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. AT3517605, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

5.5% te kuotave

Znja. Mimoza Pilika, shtetas italian , lindur më 06.10.1950, banues në Verucchio Itali , mbajtës i letërnjoftimit nr. CA92631AR, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

5.5% te kuotave

Ortakët me kërkesë të Administratorit dhe në përputhje me dispozitat në fuqi të karakterit fiskal, kanë të drejtë të kryejnë pagesa apo të japin kontribute, në kapital, ose financime në favor të shoqërisë, të cilat konsiderohen financime pa interes. Shuma e financuar, afati i kthimit dhe mënyra e rimbursimit të tyre rregullohen me kontratën përkatëse. Shumat e mesipërme mund të



perdoren per te mbuluar humbjet ose transferohen direkt ne rritjen e kapitalit ne perputhje me vendimin e asamblese se ortakëve.

NENI 6

Kapitali nuk mund te jete kurre i perfaqesuar me Letra me vlere.

NENI 7

Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise eshte PA AFAT, duke filluar aktivitetin e saj nga dita e rregjistrimit si Person Juridik ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit. Me Vendim te Ortakëve kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshoj, dhe ky Vendim i dergohet menjehere per depozitim Qendres Kombetare te Rregjistrimit, kompetente per te bere shenimet e nevojshme ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare

NENI 8

Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregetar ne keto Drejtime: Nxitjen, krijimin dhe inkurajimin e iniciativave të turizmit; planifikimin, zbatimin dhe zhvillimin e shërbimeve për projektimin, drejtimin teknik dhe menaxhimin e projekteve për realizimin me çelësa në dore të komplekseve të patundshme të të gjitha llojeve (ndërtime banesash, tregtare, industriale, turistike — hoteleri, objekte sportive, etj.); blerjen, shitjen, shkëmbimin, ndërtimin, menaxhimin dhe administrimin, si për vete dhe për llogari të palëve të treta, të çdo lloj të pasurive të patundshme dhe të bashkëpronësive të pasurive të paluajtshme; marrjen e mandateve të shitjes së sendeve të luajtshme dhe/ose të pronave të paluajtshme, qofte në pronësi të plote, në bashkëpronësi të pandare, qofte me shumë pronare; ofrimin e shërbimeve teknike, administrative dhe tregtare, dhënien me qira të pasurive të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, edhe për llogari të palëve të treta, si dhe të shitjen e të drejtave të qëndrimit Kompania do të ndërtojë dhe drejtojë objektet turistike të hotelerisë, me pajisje sportive rekreative dhe shëndetësore të përfshira në to, pa ndonjë kufizim apo shtrëngim, në tokën e saj ose të një palë të tretë, me menaxhimin e vet apo të të tretëve. Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet komerciale, industriale, financiare, menaxhim pasurish të tundshme e të patundshme që konsiderohen nga Organi Administrativ, të nevojshme ose të dobishme për arritjen e qëllimit të objektit të shoqërisë, përdorimin e burimeve financiare që lidhen me Komunitetin Evropian, në favor të shtetit, për administratën rajonale, administratën lokale apo entet që ende i atribuohen administratave të tilla, për , grupet financiare, publike ose private, duke përfshirë këtu, për aq sa mund të jetë e nevojshme, ofrimin e mbështetjes dhe dhënien e garancive, si dhe krijimin e garancive reale edhe ndaj detyrimeve të palëve të treta. Shoqëria mund të marrë si drejtpërdrejtë, dhe në mënyrë të tërthortë, interesa dhe pjesëmarrje, në çdo formë, në kompani dhe ndërmarrje të tjera, që janë themeluar apo do të themelohen, me objekt të ngjashëm të shoqërisë, të përafërt apo që perputhen me objektin e saj. Shoqëria mund të marrë dhe lëshojë, kontrata përfaqësimi, të marrë e të japë kontrata të konsulencës, të marrë



pjesë në sipërmarrjet e përbashkëta, në konsorciume ose grupe kompanish kombëtare dhe ndërkombëtare. Veprimtaritë e përmendura mund të kryhen, pasi konsiderohen nga administratoret si shumë të dobishme për arritjen e qëllimit të dispozitave të objektit social të saj

NENI 9

Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik që nga dita e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit. Ushtrimin e Aktivitetit tregëtar e fillon pasi të jetë regjistruar dhe pajisur me Certifikatën NIPT nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarinë tregëtare në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi, si ato tregëtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore specifike për ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimtarisë së saj, si dhe mbi bazën e Aktit të Themelimit si dhe Statutin e saj.

KREUII:

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11


Shoqeria cel Llogari Bankare në leke vendi dhe çdo lloj valute të huaj, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj. Administratoret e Përgjithshëm të caktuar prej ortakëve, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është celur llogaria dhe kryejnë të gjitha veprimet e duhura financiare për arritjen e objektit të shoqërisë sipas kompetencave të përcaktuara në këtë Statut

NENI 12

Pjesët e Kapitalit Themeltar, janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

NENI 13

Kapitali Themeltar i Shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e Vendimit me shkrim që merret nga Asambleja e ortakëve, i cili nënshkruhet prej tyre dhe dokumentohet duke bërë depozitim të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, e cila edhe e ka regjistruar Shoqërinë Person Juridik.



KREU III:

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE, TE DREJTAT DHE DETYRAT

NENI 14


ASAMBLEJA

Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimor i shoqerise. Vendimet e saj merren ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me kete Statutin dhe jane te detyrueshme. Ato protokollohen ne nje regjister te vecante ne perputhje me ligjin. Asambleja ka te drejte te ushtroje ne cdo moment verifikime mbi Administratoret dhe te kontrolloje cdo dokument te shoqerise. Ajo mund te urdheroje apo te udhezoje administratorin/et ne kryerjen e detyres se tij.

Asambleja ka keto kompetenca:

- ~ Vendos per percaktimin e politikave tregtare te shoqerise dhe strategjive te zhvillimit, perfshire edhe investimet kapitale;
- ~ Vendos per ndryshimet e statutit;
- ~ Emeron dhe shkarkon Administratoret, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te Miratuar, si dhe percakton shperblimet e tyre;
- ~ Vendos per zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- ~ Vendos per transferimin (blerjen, shitjen dhurimin, shkembimin) e pasurive te shoqerise, per cedimin apo per dhenien me qira te shoqerise ose degeve te saj, per dhenien me qera te aseteteve te shoqerise;
- ~ Vendos per miratimin e huamarrjeve me interes nga te tretet;
- ~ Vendos per dhenien e garancive hipotekore, pengut, barreve siguruese, dorezanise etj;
- ~ Miraton Bilancet, pasqyrat financiare dhe raportet e eksperteve kontabel te miratuar;
- ~ Miraton shperdarjen e fitimit, nepermjet ndarjes se dividenteve ose vendos per kapitalizimin e tyre nepermjet zmadhimit te kapitalit;
- ~ Miraton strukturen organizative te shoqerise, rregulloren e brendeshme dhe organogramen, rregulloren e sigurimit teknik, si dhe politikat dhe nivelin e pagave dhe shperblimeve per cdo vend pune ne shoqeri;

Menyra e Thirrjes se Asamblese



Asambleja thirret nga Administratoret ose nga ortakët e shoqërisë, nepermjet nje njoftimi me shkrim. Njoftimi me shkrim duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites dhe duhet t'i dergohet te gjithë subjekteve te interesuar, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e Asamblese.

Megjithate jane te vlefshme edhe mbledhjet e Asamblese qe nuk jane thirrur si me sipër, nese eshte i perfaqesuar i gjithë kapitali dhe nese ne mbledhje asiston Adrnistratoret dhe eksperti kontabel i miratuar (nese ben pjese ne strukturen se shoqërisë).

Ne Asamble duhet te marrin pjese te gjithë ata qe figurojne te regjistruar ne librin e ortakëve.

Ortaku ka te drejten e votes ne Asamble ne proporcion me kuoten qe zoteron ne kapitalin e shoqërisë. Ortaku mund te perfaqesohet vete, ose nepermjet nje personi te pajisur me prokure, i cili nuk duhet te jete administrator, apo ekspert kontabel i autorizuar ose vartes i vete shoqërisë apo ndonje shoqërie tjetër te kontrolluar prej saj. I takon Administratoreve te verifikojë te drejten e pjesemarrjes per ortakun.

. Asambleja drejtohet. nga Administratoret dhe ne mungese te tyre, pjesemarrësit ne mbledhje, me shumice absolute te kapitalit prezent ne salle, zgjedhin nje drejtues.

Asambleja emerone nje sekretar edhe jashte bashkësisë se ortakëve. Sekretari mban P/verbalin e mbledhjes i cili duhet te permbaje:

- ~ a) daten kur eshte marre vendimi;
- ~ b) identitetin e votuesve dhe kapitalin qe ata perfaqesojne
- ~ c) identifikimin e ortakëve pro , abstenues ose kundra
- ,- d) sipas kerkeses se ortakëve deklarimet e tyre mbi vendimin e marre;

Vendimi i Asamblese duhet te nenshkruhet nga ortakët e shoqërisë prezent ne mbledhje dhe ne munges te tij nga personi i autorizuar nga vete ai, si dhe nga sekretari. Kur e parashikon ligji, apo kur administratori e sheh te arsyeshme, P/Verbali i mbledhjes mbahet nga nje noter i zgjedhur prej tij.

Kuorumi dhe Vendimarrja

Vendimet e Asamblese qe merren me shumice te zakonshme,jane te gjitha vendimet e Asamblese per te cilat Ligji dhe Statuti nuk kerkojne nje shumice te cilesuar.

Vendimet qe merren me shumice te zakonshme jane te vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortakët (mete drejte vote) qe zoterojne me shume se 50 per qind te kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me shumicen e votave te ortakëve



pjesemarres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, mete njejin rend dite.

Per Vendimet e Asamblese qe merren me shumice te cilesuar, mbledhja eshte e vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortaket (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se 2/3 e numrit total te kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me 2/3 e votave te ortakeve pjesemarres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar me siper, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejin rend dite.

Merren me shumice te cilesuar keto vendime:

Ndryshimi i Statutit;

> Zrnadhirni ose zvogelirni i kapitalit;

> Riorganizimi (shendrrimi, bashkimi, ndarja) si dhe/ose prishja e shoqerise,

> Shperndarja e fitimeve ose kapitalizimi i tyre;

> Percaktimi i politikës dhe mases se pagave dhe shperblimeve per cdo pozicion pune ne shoqeri, duke pershire edhe percaktimin e pages apo shperblimin e Administratorit, ekspertit kontabel te miratuar dhe likujduesve;

NENI 15


Ortakët me ane te Administratorve, ushtrojne dhe keto Tagra (te Drejta) :

Mundesohen per te kryer te gjitha aktet dhe veprimet juridike qe konsiderohen se jane te domosdoshme per ushtrimin e gjithanshem dhe fitimprures te veprintrarise tregetare te Shoqerise sipas qellimeve dhe objektivave te saj sic; mund te jene:

1. Te lidhin Kontrata te ndryshme qe kane per objekt Blerjen, shitjen, kembimin dhe marrjen me qera te Pasurive te ndryshme (te luajtshme dhe te paluajtshme), ate te servitutit, uzufuktit Enfiteozes, Franchising, Siper marrje Ndertimi, etj si me persona fizike dhe me Persona juridike vendas apo te Huaj, me shtetin dhe ne rastin e blerjes te Pasurive te Paluajtshme apo marrjen e tyre me qera per nje kohe mbi 9 vjet, si dhe te Kontratave te Servitutit, Uzufuktit dhe Enfiteozes, duhet te bejne rregj istrinin prane Drejtorive Vendore te Agjesise Shteterore te Kadastrave te rrethit te juridiksionit perkates si per transkriptimin e Pronesise ne favor te Shoqerise apo kalimin e kesaj pasurie ne posedim ligjor.

Cdo blerje e pasurive te mesiperme, konsiderohet dhe si shtese e Kapitalit ne Natyre

2. Te kryejne cdo lloj veprimi prane te gjitha Zyrave shteterore dhe Private, Bankat e cdo niveli etj, qe kane te . bejne . me Garancite, Siper marrjet, marrjen e Kredive, te




Siguracioneve dhe Risiguracioneve per jeten dhe Dermet, Transportit (brenda vendit dhe jashte shtetit) kryerjen e veprimeve doganore per zhdoganimin e mallrave te importuara deklarimin e atyre te eksportuar, plotesimit ne kohe dhe me rregullsi te dokumentacionit Fiskal, Tatimor, Bankar etj

NENI 16

ADMINISTRIMI

- Te kryej te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise;
- Te zbatoje politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e pergjithshrne;
- Te perfaqesoje shoqerine tregtare perpara te treteve;
- Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- Te pergatise dhe te nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise;
- Te pergatise buxhetin vjetor te shoqerise.
- Te pregatise propozimet per shperndarjen e fitimeve dhe t' i paraqese keto dokumente perpara Asamblese per miratim;
- Te krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- Te kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kornbetare te Regjistrimit;
- Te raportoje perpara Asarnblese ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- Te propozoje dhe ti paraqesi Asamblese per miratim strukturen organizative te shoqerise, rregulloren e brendeshme, organogramen dhe rregulloren e sigurimit teknik;
- Te mos kryeje veprimtari konkurruese (ndalimi i konkurences) me veprimtarie qe kryen shoqeria.
- Administratori ka te drejte te rimbursohet per shpenzimet e bera per arsye pune si dhe te drejten e nje rroge mujore te aprovuar nga Asambleja.



Administratori mund te kryeje edhe detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut. Ata mund te vene ne levizje instanca juridike dhe administrative, duke erneruar avokate e duke leshuar prokura ne raste gjyqesh, duke kryer operacione bankare, ketu perfshire edhe hapjen apo mbylljen e llogarive rrjedhese, nenshkrimin dhe xhirimin e ceqeve, realizimin e terheqjeve dhe derdhjeve me leke ne dore apo urdher xhirimi, tituj .krediti, paradhenie krediti.

Administratoret e shoqerise , per nevojat e ushtrimit te aktivitetit te shoqerise , kane te drejte te marrin ne pune specialiste me shtetesi te ndryshme duke lidhur Kontraten sipas kritereve qe paras hikohen ne Kodin e Punes ne fuqi, dhe shtesat e mepasme plotesuese te tij dhe me Ligjin "Per Sigurimet Shoqerore" si dhe ne perputhje me rregullat teknike dhe te disiplines profesionale te caktuara nga ana e punedhenesit.

KREU IV:

Pasqyrat Financiare dhe Shperndarja e Shoqerise

NENI 17

Veprimet ekonomiko financiare te Shoqerise, mbyllen me daten 31 Dhjetor te cdo viti.

Hartimi i Pasqyrave Financiare vjetore, behet duke respektuar rregullat mbi Kontabilitetin dhe publikohen brenda 3 muajve nga data e mbylljes se vitit financiar.

Per nxjerrjen e rezultatit Kontabel te Shoqerise, mbi bazen e Aktivit dhe Pasivit, me vendim te Ortakeve caktohet nje Ekspert Kontabel i Autorizuar.

Eksperti ka per detyre te kontrolloje dhe verifikoje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise Ekonomiko tregtare te Shoqerise, si ate vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te ti lie mbi bazen e Vendimit te marre nga Ortaket e Shoqerise.

Ne perfundim te Kontrollit, Eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatatit perfundimtar te Bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese dhe dorezoje ne kohe Mbledhjes se Asamblese , i cili eshte Organi i vetem per ti shqyrtuar dhe vendosur miratimin e tij.

NENI 18

Nxjerrja e rezultateve te Pasqyrave Financiare vjetore, duhet bere me saktesi dhe duke respektuar te gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe Ligjeve Fiskale ne fuqi, te cilat jane te detyrueshme per tu zbatuar nga cdo subjekt privat qe ushtron veprimtari tregtare.

Eksperti Kontabel i autorizuar pervec te drejtave, ka dhe keto detyrime:



1. Garanton Asamblen e Ortakeve se llogarite vjetore jane te rregullta dhe Bilanci eshte nxjerre me saktesi dhe konform rregullave te Ligjit " Mbi Kontabilitetin".
2. Te pasqyroje me vertetesi rezultatet e operacioneve te vitit te kaluar financiar dhe gjendjen reale financiare te Shoqerise ne mbylljen e vitit financiar te aktivitetit tregtar te saj.
3. Te verifikojte perputhje.t me llogarite vjetore te Informacioneve te dhena nga Adrnistratoret e Shoqerise dhe Ortakut, duke perfshire dhe dokumentat per gjendjen financiare qe ai (Administratori) i ka paraqitur Asarnblese.

4 T'i beje te njohur Ortakeve dhe Adrnistratoreve te hoqeri e: Kontrollet dhe verifikimet qe jane bere prej tij per kontrole periodike ose vjetore,duke ene ne dukje parregullsitate apo pasaktesite e konstatuar,masat ligjore per rregullimin e tyre etj.

5 Eksperti Kontabel i autorizuar eshte pergjegjes ndaj hoqeri e dhe ndaj te treteve per pasojat e demeshme te shkaktuara me fajin e tij (Dashje ose pakujde i) aktivitetit tregtar te Shoqerise, por nuk eshte pergjegjes kur keto DEME shkaktohen pa dijenin e tij dhe nga veprimet me faj te Adrnistratoreve te Shoqerise.

NENI 19

Pasqyrat Financiare vjetore, miratohen mbi bazen e Vendimit me shkrim te marre nga Ortaket ne Mbledhjen e Asamblese, ne te cilen jo vetem qe dokumentohet aprovimi e tyre por vendos dhe ne lidhje me disponibilitetin e Fondeve ligjore, sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te aktivitetit te Shoqerise por dhe per Garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke patur parasyesh Fondin e Akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

Per Formimin e fondit rezerve, qe emertohet "Rezerve e domosdoshme" Ortaku vendos qe nga fitimi i akumuluar gjate vitit financiar, pasi te zbriten humbjet e vitit te meparshem, te lere te pakten 1/20 e vleres se fitimit te realizuar.

NENI 20

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimet e realizuar gjate vitit financiar te sapo mbyllur. Asambleja mund te vendose per formimin e fondeve te ndryshme dhe shperndarjen e tyre. N

Asambleja pasi ka miratuar Pasqyrat Financiare perfundirntar dhe ka vendosur shumen qe do te shperndahet, percakton pjesen e fitimit per secilin ortak ne raport me kuoten qe zoteron secili.



Shoqeria mund t'u shperndaje fitime ortakeve, vetem nese Administratori, nen pergjegjesine e tij personale, leshon nje certifikate te aftesise pagese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat nenit 77 te Ligjit "Per Tregtarin dhe Shoqerite Tregtare"

Dividendet qe nuk korrespondojne me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakeve qe i kane marre ato

NENI 21

Shpemdarda ose Prishja e Shoqerise, mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar Shoqeria sic; mund te jene:

- a. Humbja e Kapitalit ose pamundesia e vazhdimet te metejshem te veprimtarise se saj.
- b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga Ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare".
- c. Me kerkesen e Ortakeve Thernelues.

Ne kete rast Ortaket marrin Vendim me shkrim ne te cilin parashikohen e dhe menyren e Likudimit te Shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe leshuar ne cdo dokument te nxjerre prej tyre emrin e Likuidatorit.

NENI 22

Akti i Emerimit te Likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon Ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.


NENI 23

Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korekt si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cilave Shoqeria eshte Kreditore dhe per ekzekutimin e plote te detyrimeve (debive) qe Shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te vecante apo personave fizike ose juridik vendas apo te huaj

NENI 24

Cdo mosmarrveshje apo kontlikt qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise me te trete, si rregull dhe pergjithesisht duhet te zgjidhet ne mirekuptim, ne te kunderten ceshtjen mund ta bejne objekt konflikti gjyqesor, duke ngritur padi ne Gjykatën e rrethit Tirane ose ne Gjykata Administrative.


NENI 25



Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut i referohet udhezimeve plotesuese e konform akteve ligjore e nenligjore ne fuqi si dhe hapsirave juridike lejuese te Legjislacionit ne fuqi dhe normave nderkombetare.

NENI 26

Ky STATUT u redaktua ne 6 kopje ne gjuhen shqipe dhe italiane dhe me permbajtje e vlere te njejta juridike dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket Themelues te Shoqerise tregetare "Enso Holding" sh.p.k, nenshkruhet ne te gjitha ekzemplaret duke u vene emri, mbiemri dhe firma origjinale



ORTAKETTHEMELUESTESHOQERISE

Enso Holding" sh.p.k.

Miratuesit e ketij Statuti

(ORT AKET E SHOQERISE)

Avni Delyina

Nimete Delvina

Reveka Delvina

Melios Delvina

Ymer Delvina

Skender Delvina

Mimoza Pilika

Eros Delvina

Dajana Delvina



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER PERIAN B. BODINAKU
ADRESA Ç. TOPULLI
TEL: 674010104

VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 1329

Tirane më 30/01/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021052640084525346

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER PERIAN B. BODINAKU**



V2021052640084525346

**DATE 30/01/2021
NR REP 1329**

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, para meje Notere PERIAN B. BODINAKU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Ç. TOPULLI, u paraqit personalisht:

DEKLARUESIT:

Skënder Delvina, atësia Mehmet, amësia Reveka, shtetas Shqiptar, lindur në Vlore dhe banues në TIRANË, me adresë E Dibrës; Nd. 413; H. 1; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1012; Tiranë, lindur më 24/08/1974, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031810945 dhe nr. personal H40824035J , .

Reveka Delvina, atësia Todi, amësia Katina, shtetase Shqiptare, lindur në Vlore dhe banues në TIRANË, me adresë E Dibrës; Nd. 413; H. 1; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1012; Tiranë, lindur më 25/10/1946, gjendja civile “e ve”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 028623372 dhe nr. personal E66025055V , .

Ymer Delvina, atësia Mehmet, amësia Reveka, shtetas Shqiptar, lindur në Vlore dhe banues në TIRANË, me adresë E Dibrës; Nd. 413; H. 1; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1012; Tiranë, lindur më 28/09/1979, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031813428 dhe nr. personal H90928042U , .

Melios Delvina, atësia Mehmet, amësia Reveka, shtetas Shqiptar, lindur në Vlore dhe banues në TIRANË, me adresë E Dibrës; Nd. 413; H. 1; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1012; Tiranë, lindur më 16/01/1987, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031457424 dhe nr. personal I70116063D , .

Nimet Delvina, shtetas Shqiptar, banues në Verucchio , Itali, lindur më 11.02.1924 , madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. C45211010P.

Dajana Delvina, shtetas Italiane, banues ne Santarcangelo , Itali, lindur më 10.05.1984 , madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. CA72607HM.

Eros Delvina, shtetas Italian, banues ne Verucchio , Itali, lindur më 01.06.1986 , madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. AT3517605.



V2021052640084525346

Mimoza Pilika, shtetas Italian, banues ne Verucchio , Itali, lindur më 06.10.1950 , madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. CA92631AR.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, **Statut i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " Enso Holding" sh.p.k** , bashkëlidhur.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

PERIAN B. BODINAKU